



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës



Raport i Punës për tremujorin e parë

Prill-Qershor, 2024

Prishtinë, Korrik 2024

Ky raport paraqet punën e OMK-së për periudhën Prill-Qershor të vitit 2024.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të OMK-së, duke u koncentruar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së Odës.

Përmbajtja:

1. Këshilli Drejtues.....	4
3. Anëtarësimi	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	7
6. Licencimet.....	7
7. Këshilli Mbikëqyrës	8
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	8
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke	8
11. Raporti financiar.....	8
11.1. Raporti financiar për periudhën Janar - Mars 2024.....	9
12. Aktivitete të tjera.....	10
12.1 Revsita Mjeku – Trakti tretës	10
12.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim.....	10
12.3 Marrëdhëniet ndërkombëtare	11
12.4 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike.....	12
13. Plani i veprimit për 2024.....	12


1. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën prill-qershor	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	5	11	0	<ul style="list-style-type: none"> - Vendim për themelimin e Komisionit Ad-Hoc për përpilimin e kriterëve, vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve shkencore për vitin 2023; - Vendim për miratimin e Pasqyrave Financiare dhe Raportit të Auditorit për vitin 2023; - Vendim për numrin ISBN për librin e abstraktit për Kongresin e VI të Mjekësisë; - Vendim për zbatimin e pagës së kuotës së anëtarësisë vjetore për mjekët të cilët arrijnë moshën e pensionimit; - Vendim për iniciimin e procedurës së prokurimit për realizimin e hulumtimit për BURNOUT - Vendim për iniciimin e procedurës së prokurimit për organizimin e simpoziumit të Odave të Mjekëve të Europës Lindore dhe Juglindore (ZEVA) 	0

2. Anëtarësimi

Në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 44 mjekë, nga të cilët 5 mjekë të punësuar në sektorin publik, 4 mjekë të punësuar në sektorin privat dhe 35 mjekë të papunë.



Grafiku 1.1: Anëtarësime për periudhën kohore Prill – Qershor 2024



Grafiku 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 Qershor 2024

Gjatë kësaj periudhe është ndarë nga jeta 6 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 7 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 Qershor është 5440 mjekë.


3. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë Prokurorit të OMK-së, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e Prokurorit të OMK-së.

ORGANI	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën Prill-Qershor	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën Prill-Qershor	Sanksionet e shqiptuara për periudhën Prill-Qershor	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën Prill-Qershor	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	22	9	N/A	N/A	12	34
Këshilli Etik	6	8	2 Gjoba	1 Shpenzim administrativ	4	8
Gjyqi i Nderit	1	1	///	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	80	///	///	///	///	///


4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, ka akredituar gjithësejt 31 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, 8 prej këtyre akreditimeve janë me taksë administrative, 7 përkrahje financiare, 1 përkrahje financiare e refuzuar dhe 1 lënde e pezulluar.



5. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional, ka lëshuar gjithësejt **184** licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



6. Këshilli Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur 4 takime, është dërguar një rekomandim lidhur më një vendim të komisionit për solidaritet dhe ndihme reciproke. Gjithashtu është shqyrtuar edhe Raporti i punës së OMK-së, Pasqyrat financiare dhe raporti i Auditorëve privat, Vendimet e Këshillit Drejtues, dhe të organeve të tjera të OMK-së.

8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsejt 11 kërkesa, për të cilat ka nxjerrë 11 vendime aprovuese. KÇE për 11 kërkesa të shqyrtuara ka nxjerrë 11 Vendime aprovuese nga të cilat 10 vendime për leje-hulumtim, 1 vendim për kthim raporti.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej 12 kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë 11 vendime për aprovimin e kërkesave të parashtruara nga palët dhe 1 vendim për refuzim të kërkesës.

10. Raporti financiar

10.1. Raporti financiar për periudhën Prill- Qershor 2024

RAPORTI FINANCIAR DERI ME 30 QERSHOR 2024			
1.0 Të hyrat:			
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2023	€	825,695	
Total Paraja në bankë me 31.12.2023			€ 825,695
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:			
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 355,325	129,870.00	€ 485,195
1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,450	€ 2,100	€ 5,550
1.2.2 Licencimi	€ 14,215	€ 11,750	€ 25,965
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 9,858	€ 8,571	€ 18,428
Të hyrat deri me 30.06.2024	€ 382,848	€ 152,291	€ 535,138
Paraja në bankë me 31.12.2023			€ 825,695
TOTAL TË HYRAT			€ 1,360,833
2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	TOTAL
2.1 Paga, medetje dhe kontributet pensionale	€ 72,121	€ 69,594	€ 141,715
2.2 Material shpenzues	€ 814	€ 661	€ 1,474
2.3 Reprerentacioni	€ 1,051	€ 698	€ 1,749
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 33,660	€ 59,633	€ 93,293
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 8,620	€ 20,521	€ 29,141
2.6 Shpenzimet e asetëve	€ 634	€ 219	€ 853
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 1,750	€ 18,200	€ 19,950
TOTAL SHPENZIMET 30.06.2024	€ 118,650	€ 169,526	€ 288,176
Neto të hyrat për TM2 2024			€ 246,962
TOTAL BILANCI 30.06.2024			€ 1,072,657

Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera.

2.5*Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Medetje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

11. Aktivitete të tjera

11.1. Revista Mjeku – Trakti tretës

Vëllimi 4, Numri 2 i Revista Mjeku ka temë bosht Shëndeti riprodhues, i cili u publikua gjatë muajit Qershor 2024. Ky numër përbëhet gjithsej nga 27 artikuj të përmbledhura në 91 faqe, ku trajtohen tema interesante dhe me rëndësi për Shëndetin riprodhues. Revista është publikuar në web-faqen e OMK-së si dhe faqe zyrtare të facebookut. Të bashkangjitur gjeni mëposhtë linkun e publikimit të këtij numri:

<https://omk-rks.org/wp-content/uploads/REVISTA-MJEKU-Vellimi-4-Numer-2-Shendeti-riprodhues.pdf>

12.1 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim

Në kuadër të marrëveshjes për delegimin e fondeve dhe zbatimin e aktiviteteve, është paraparë edhe ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së. Gjatë muajit qershor, në kuadër të bashkëpunimit mes Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Asociacionit Mjekësor të Gjermanisë, stafi profesional dhe përfaqësues të organeve të OMK-së realizuan një vizitë studimore në Asociacionin Mjekësor të Gjermanisë dhe Odën e Mjekëve të Berlinit. Gjatë kësaj vizite, u diskutua mbi vetëqeverisjen e mjekëve dhe rolin e odave mjekësore në sistemin shëndetësor gjerman, si dhe mbi mbarëvajtjen e punës për ofrimin e shërbimeve më të mira ndaj anëtarëve të këtyre odave.

Qëllimi i këtyre vizitave është ngritja e kapaciteteve të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe forcimi i rolit të këshilleve/komisioneve brenda odës.

12.2 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Asambleja e 128-të e Asociacionit Mjekësor të Gjermanisë

Me ftesë të Asociacionit Mjekësor të Gjermanisë përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morrën pjesë në Asamblen e 128-të të këtij asociacioni.

Pikat kryesore të diskutimit në këtë asamble ishin:

- Kujdesi shëndetësor i së ardhmes – më shumë koordinim i kujdesit dhe orientim më i mirë për pacientët
- Mungesa e punëtorëve shëndetësor të kualifikuar
- Reforma strukturore spitalore, Aktit për Forcimin e Kujdesit Shëndetësor

Në kuadër të asambles, u organizua një takim mes përfaqësuesve të Odave të Europës Qëndrore dhe Lindore (ZEVA) ku u diskutua lidhur me temat e takimit të ardhshëm të ZEVA, takim i cili do të mbahet nga 5 deri 7 Shtator 2024 në Prishtinë. Në takimin e Prishtinës u vendos të elaborohen tri tema:

- Roli i odës së mjekëve në trajnimet për shkollimin specialistik
- Çfarë përgjegjesi kanë odat e mjekëve për licencimin e anëtarëve të tyre pensionist. Rregullat e punës dhe procedurat për mjekët pas pensionimit.
- "Shpenzimi" profesional i mjekëve (burnout). Migrimi i mjekëve dhe opsionet për reduktimin e trendit. Metodot e përdorura nga shtetet

Me ftesë të kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës, pjesëmarrës në këtë takim do të jenë edhe përfaqësues nga shoqatat mjekësore të Ukrainës.

12.3 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën prill-qershor	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën prill-qershor	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën prill-qershor	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	3	1	1	0	0

Në këtë periudh kohore lëndët e pranuar nga Gjykatat dhe Prokuroritë janë kthyer prapa me arsyetimin sepse nuk është duke u ekzekutuar asnjë pagesë e ekspertëve të caktuar nga Oda e Mjekëve.

13 Plani i veprimit për 2024

Projektet/Planet 2024

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuar deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejën për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës. Hapi i ardhshëm i projektit është që të bëhet plani detal i objektit nga arkitektët, si rezultat OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development të bëjnë hapjen e tenderit për fillimin e punimeve.
- Lansimi i Platformës digjitale për menaxhimin e profesionistëve shëndetësorë, ku do të përfshihen të gjitha proceset dhe shërbimet e OMKsë. Stafi profesional janë

në fazën e mbajtjes së trajnimeve dhe testeve përfundimtare të përdorimit të platformës, dhe në realizim të videos informuese për anëtarët e OMK-së për përdorim të platformës, ku gjithashtu me datë 02.09.2024 planifikohet të filloj përdorimi i platformës nga të gjithë anëtarët e OMK-së.

- Organizimi i simpoziumit të përvitshëm ZEVA 2024.
- Organizimi i Kongresit të VI të Mjekësisë, me temën “Sfidat e Diagnostikës së Mijëvjeçarit”.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK dhe SHSKUK.
- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshjes për Delegimin e Fondeve dhe Implementim projekti KSV/017-21 2749. Deri në fund të vitit janë të planifikuara të realizohen një vizitë studimore dhe tre trajnime.
- Hulumtim për vlerësimin e sindromit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve). Qëllimi i hulumtimit është të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse të djegies profesionale (burnout) të mjekëve në Kosovë. Ky hulumtim do të realizohet gjatë tremujorit të tretë.